





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. 1256 Prot. Shkodër, më 10/8 / 2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
MBROJTJES SOCIALE

TIRANË

Nr. 1592 / Prot. Tiranë, më 08/08 / 2023
58

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot me datën 08.08.2023, mes palëve:

BASHKIA SHKODËR me adresë Rr: '13 Dhjetori', Nr.1 Shkodër, përfaqësuar me vendim delegimi Nr.206 datë 28.07.2023 "Për delegim kompetence" nga **Zv.Kryetari z. Rudin Beka**, identifikuar me dokument identifikimi me nr. **I209210971**.

dhe

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, Adresa: Rruga e Kavajës 1001, Tiranë, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm (ngarkuar në detyrë) **Zj. Mejvis KOLA**.

BAZA LIGJORE:

- Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar.
- Ligji 115/2014 "Për ndarjen administrativo territoriale të njësive të qeverisjes vendore në R.Sh" të ndryshuar.
- Ligji nr. 107 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" të ndryshuar.
- VKM nr. 421 dt.02.06.2010 "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës" të ndryshuar.
- VKM Nr. 52 datë 16.01.2013 "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës ana e Malit, të Qarkut të Shkodrës".
- VKM nr. 944 datë 17.11.2010 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Dajç, të Qarkut të Shkodrës".
- VKM Nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" të ndryshuar.

- VKK nr.33. dt.11.12.2013 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Velipojë.
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" të ndryshuar.
- Kontratë sipermarrje Nr.1592/21 prot datë 11. 07. 2023 për kryerjen e punimeve për "Rikonstruksion i Qendrave Shëndetësore (viti 2023-2024)", i ndarë në lote, Loti.3 "Rikonstruksion i disa Q.SH-ve në qarqet Shkoder, Kukës, Lezhë, Dibër" , konkretisht QSH - Fshati: "Oblikë"; Q.Sh – Fshati: "Dajç" dhe Q.Sh – Fshati: "Velipojë" Bashkia - Shkodër.
- Shkresa me nr. 869 prot. datë 19.07.2023 Kërkesë për miratim leje fillim punimesh.

Neni 1 Objekti

1.1 Zbatim i kontratës së sipërmarrjes Nr.1592/21 Prot. dt.11.07.2023 me objekt "Rikonstruksion i Qendrave Shëndetësore (viti 2023-2024)", i ndarë në lote, Loti.3 "Rikonstruksion i disa Q.SH-ve në qarqet Shkoder, Kukës, Lezhë, Dibër" , konkretisht QSH - Fshati: "Oblikë"; Q.Sh – Fshati: "Dajç" dhe Q.Sh – Fshati: "Velipojë" Bashkia - Shkodër.

Neni 2 Gjuha e marrëveshjes

2.1 Gjuha e marrëveshjes së bashkëpunimit është gjuha shqipe.

Neni 3 Qëllimi

3.1 Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet me qëllim përmirësimin e infrastrukturës të Qendrave Shëndetësore – Q.Sh – Fshati: "Oblikë"; Q.Sh – Fshati: "Dajç" dhe Q.Sh – Fshati: "Velipojë" Bashkia - Shkodër.

Neni 4 Afati i marrëveshjes

4.1 Afati i kësaj marrëveshje bashkëpunimi është nga data e nënshkrimit nga palët deri në marrjen në dorëzim të punimeve të kryera nga bashkia Shkodër.

Neni 5 Të drejtat dhe detyrimet e palëve

5.1 Të drejtat dhe detyrat e Bashkisë Shkodër:

- Bashkia Shkodër nëpërmjet Drejtorisë së Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve si dhe Drejtorisë së Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, marrin përsipër të realizojnë procedurat ligjore dhe teknike në zbatim të dispozitave ligjore të parashikuara.
- Struktura përgjegjëse për trajtimin e kërkesave të punimeve të ndërtimit angazhohet konform dispozitave ligjore të paisë me lejet e nevojshme për kryerjen e punimeve për rikonstruksionin e 3 (tre) Qendrave Shëndetësore të sipërcituar.
- Bashkia Shkodër (nëpërmjet strukturës përgjegjëse të ngritur) gjatë realizimit të projektit do të ndjekë zbatimin e punimeve sipas dispozitave ligjore në fuqi. Në përfundim të zbatimit të projektit struktura përgjegjëse do të angazhohet për verifikimin e kryerjes së punimeve, procesin e marrjes në dorëzim të punimeve të kryera dhe në procesin e

kontabilizimit të vlerës së shtuar të investimit në rregjistrat kontabël si asete të bashkisë Shkodër.

5.2 Të drejtat dhe detyrat e Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale merr përsipër realizimin e plotë të projektit sipas kontratës së sipërmarrjes nr.1592/21 Prot. dt.11.07.2023, të nënshkruar nga Sipërmarrësi: "Company Riviera 2008 "shpk dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas kushteve dhe projekt - preventivit, pjesë përbërëse e kësaj kontrate.
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale informon dhe kërkon nga Sipërmarrësi të paraqesë të gjithë dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik për pajisje me lejen përkatëse pranë Bashkisë Shkodër e cila realizon aplikimin nëpërmjet portalit e-albania, e-leje në cilësinë e zhvilluesit për kryerjen e punimeve dhe realizimin e projekteve pjesë e kontratës së sipërmarrjes.
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pas realizimit të projektit, brenda 10 ditësh nga kolaudimi i punimeve të kryera, dorëzon pranë Bashkisë Shkodër të gjithë dokumentacionin teknik dhe ligjor duke realizuar dhe dorëzimin e objekteve pas rikonstruksionit.

Neni 6 Detyrimi për raportim

6.1 Palët detyrohen të respektojnë kushtet e kësaj marrëveshje bashkëpunimi. Për çdo ndryshim që mund të ndodhë si për sa i përket zbatimit të kësaj marrëveshje bashkëpunimi, palët detyrohen të njoftojnë njëra tjetrën me shkrim.

Neni 7 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

7.1 Palët duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet/konfliktet që mund të lindin ndërmjet tyre në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.

7.2 Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen Gjykatës kompetente.

Neni 8

8.1 Kjo marrëveshje bashkëpunimi quhet e lidhur me nënshkrimin e saj nga palët.

Neni 9

9.1 Çdo korigjim i marrëveshjes së bashkëpunimit pas nënshkrimit të saj e bën atë të pavlefshme. Kjo marrëveshje bashkëpunimi hartohet në 5(pesë) kopje origjinale e cila pasi u lexua palëve, u pranua dhe u nënshkrua me vullnetin e tyre të plotë e të lirë.

Për

Bashkinë Shkodër

Me vendim delegimi
Zv/Kryetar

Z. RUDIN BEKA



Për

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Sekretar i Pergjithshëm
(I ngarkuar në detyrë)

Zj. MEJVIS KOLA

